



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.562/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “NT-AGA 3” me seli në Gjakovë, kundër të paditurave 1.Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë dhe 2.Komuna e Gjakovës me seli në Gjakovë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.14-334/01-44192 i të datës 25.11.2019 dhe vendimi 19/12/20, jashtë seancës me datë 28.03.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit NT-AGA 3” me seli në Gjakovë me kundër të paditurave .Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë dhe 2.Komuna e Gjakovës me seli në Gjakovë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.14-334/01-44192 i të datës 25.11.2019 dhe vendimi 19/12/20
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi NT-AGA 3” me seli në Gjakovë me datën 24.01.2020 ka parashtruar padi, kundër të paditurave .Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë dhe 2.Komuna e Gjakovës me seli në Gjakovë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.14-334/01-44192 i të datës 25.11.2019 dhe vendimi 19/12/20.

Gjykata me datë 26.02.2024 paditësit NT-AGA 3” me seli në Gjakovë i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’a paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar

paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 29.02.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.562/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.